**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

| Data: 6.5.2023 | Nr: 457 | Ora: 12:30 |
|---|---|---|

**VENDIM**
**PËR**
**MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË PËRDORIMIT TË PLATFORMËS ELEKTRONIKE TË RAPORTIMIT FINANCIAR (PERF)**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 63, pikat 1 e 2, 92/1, 92/2, 92/3 dhe 92/6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 15/2 pika 2, shkronja "a", 23, 23/1, 23/2, 23/3, 23/4 dhe 24, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar, vendimit nr. 20, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe përcaktimin e mënyrës së pagesës së audituesve ligjorë", vendimit nr. 15, datë 07.04.2023, të Komisionit Rregullator "Për miratimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/ subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V E N D O S:**

1. Miratimin e manualeve teknike të përdorimit të Platformës Elektronike Financiare (PERF), si vijon:

   a) Manual teknik përdorimi i Platformës Elektronike të Raportimit Financiar nga Financieri i Partisë Politike gjatë zgjedhjeve, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

   b) Manual teknik përdorimi i Platformës Elektronike të Raportimit Financiar nga financieri i partisë politike gjatë vitit kalendarik, sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

   c) Manual teknik përdorimi i Platformës Elektronike të Raportimit Financiar nga monitoruesit e fushatës zgjedhore, sipas shtojcës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

   ç) Manual teknik përdorimi i Platformës Elektronike të Raportimit Financiar nga auditues ligjor sipas shtojcës nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

d) Manual teknik përdorimi i Platformës Elektronike të Raportimit Financiar nga kandidatët e listave shumemërore sipas shtojcës nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

dh) Manual teknik përdorimi i Platformës Elektronike të Raportimit Financiar nga kandidatët për kryetar bashkie sipas shtojcës nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

e) Manual teknik përdorimi i Platformës Elektronike të Raportimit Financiar nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit sipas shtojcës nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Shtojca nr. 1

Co-funded by the European Union

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE

Co-funded and implemented by the Council of Europe

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

TIRANE

# Portali Elektronik i Raportimit Financiar

## Manual Teknik i Përdorimit | Financier

Raportet financiare për zgjedhje për Kuvend dhe për zgjedhje për organet e qeverisjes vendore

Shtimi i përdoruesve

## Përmbajtja

1. Hyrje ........................................................................ 3
1.1 Qëllimi i manualit ........................................................ 4
2. Ndërfaqja e identifikimit te përdoruesit në sistem ........................ 5
3. Menuja kryesore ............................................................ 10
4. Menu: Shto raport financiar ................................................ 12
5. Menu: Profili i financierit ................................................ 29
6. Menu : Shto kandidat ....................................................... 29
7. Menu : Raportet e partisë politike ......................................... 31

*Ky manual është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.*

# 1. Hyrje

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve.

Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore, të medies në raport me zgjedhjet.

Zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat në lidhje me procesin zgjedhor.

Ligji nr. 101/2020 krijoi një arkitekturë të re të administrimit zgjedhor me formimin e tri organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që janë:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

2. Komisioni Rregullator;

3. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Veprimtaria e KQZ-së, organeve drejtuese dhe administratës udhëhiqet sipas rastit nga Kodi Zgjedhor, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe nga ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka planifikuar digjitalizimin e procesit të monitorimit të raporteve financiare të partive politike bazuar në kuadrin ligjor në fuqi: Kodi Zgjedhor, ligji për partitë politike dhe aktet nënligjore të KQZ-së për financimin e subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore. Është evidentuar nevoja për të zhvilluar një platformë online për të lehtësuar procesin e monitorimit të financave të partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Ky portal do të përmbajë disa faza të rëndësishme të financimit të partive politike për KQZ-në, që nga momenti i vetëdeklarimit të pasqyrave financiare nga partitë politike si për vit jozgjedhor, ashtu edhe për fushata zgjedhore, monitorimi i tyre gjatë procesit zgjedhor, përfshirja e KQZ-së përgjatë procesit të auditimit (komunikimet auditues - financier partie) dhe në fund vendimmarrja.

Portali i deklarimit online do të lehtësojë procesin e plotësimit të raporteve financiare, raporteve të monitoruesve gjatë fushatës zgjedhore dhe raporteve të auditimit duke i mundësuar në mënyrë elektronike, të shpejtë, të sigurt dhe duke minimizuar gabimet e mundshme nëpërmjet zhvillimit të dokumenteve të sigurta elektronike.

## 1.1 Qëllimi i manualit

Manuali ka për qëllim shpjegimin e funksionaliteteve kryesore të ofruara nga ky sistem duke i ardhur në ndihmë financierit, si përdorues i sistemit.

Të gjitha funksionalitet që ofron portali do të përshkruhen dhe do të ilustrohen me imazhe për të dhënë një shpjegim sa më të mirë të të gjithë proceseve të sistemit.

## 2. Ndërfaqja e identifikimit të përdoruesit në sistem

Përdoruesi do të aksesojë ndërfaqen e portalit nëpërmjet linkut të autorizuar nga KQZ-ja.

Përdoruesi plotëson fushat **E-mail"** dhe **Fjalëkalimi** dhe më pas klikon **"Identifikohu"** për t'u identifikuar në sistem.

Përdoruesit do t'i kërkohet të ndryshojë fjalëkalimin me një përdorim që i jepet nga KQZ-ja.




Nëse përdoruesi vendos kredenciale të pasakta të **E-mail-it** dhe **Fjalëkalimit,** do t'i shfaqet një mesazh që e lajmëron për kredenciale të pasakta.



Nëse përdoruesi ka harruar fjalëkalimin e tij dhe dëshiron ta ndryshojë, ai mund të klikojë mbi butonin “**Harrove Fjalëkalimin?”**




Duke klikuar mbi butonin “**Harruat fjalëkalimin?”**, përdoruesit do t’i kërkohet që të vendosë *e-mail*-in e regjistrimit nga KQZ-ja, ku do t’i dërgohet një kod.



Përdoruesi plotëson fushën me *e-mail*-in e tij dhe klikon mbi butonin **“Dërgo kodin”**.




Përdoruesi hyn në adresën e *e-mail*-it, merr kodin e verifikimit që i është dërguar, e vendos tek ndërfaqja ku i është kërkuar dhe klikon butonin **“Konfirmo”.**



Përdoruesi vendos dhe konfirmon fjalëkalimin e ri. Pasi janë plotësuar fushat e fjalëkalimit, ai klikon mbi butonin “**Ruaj”** për të ndryshuar fjalëkalimin e tij.




Fjalëkalimi që vendos përdoruesi duhet të përmbajë 8 karaktere ose më shumë.

Nëse përdoruesi vendos një fjalëkalim që nuk përmbush standardin, fjalëkalimi shfaqet me një vijë të kuqe dhe nuk mund të ruhet.




Nëse kodi nuk është dërguar ose ka skaduar, përdoruesi duhet të klikojë tek opsioni **“Nuk morët një kod? Ridërgo kodin”**.




Përdoruesi ka vendosur kredenciale të sakta dhe është identifikuar në sistem. Pas kësaj ai do të shohë ndërfaqen me rolet e tij përkatëse.

# 3. Menuja Kryesore

Në menunë kryesore "**Informacion i Përmbledhur**", përdoruesi do të shohë në mënyrë grafike paraqitjen e përdoruesve të shtuar prej tij në sistem (kandidatë dhe miratues raportesh financiare), si dhe raportet e partisë (raporte vjetore, raporte për zgjedhjet për Kuvend, raporte për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore).




Përdoruesi do të shohë *Menunë Kryesore Vertikale* që përmban: “**Informacion i Përmbledhur**”, “**Shto Raport Financiar**”, “**Shto Kandidat**”, “**Shto Miratues të Raporteve**”, “**Raportet e Partisë Politike**” dhe “**Raportet e Kandidatëve**”.




Përdoruesi do të shohë *Menunë Horizontale* në të djathtë që do të ketë ikonën e profilit të përdoruesit, emrin me rolin e përdoruesit, ikonën e njoftimeve dhe ikonën e daljes nga sistemi.



# 4. Menu: Shto raport financiar

Për të shtuar një raport financiar, përdoruesi duhet të klikojë  tek menuja **“Shto raport financiar”.**




Për të shtuar një raport financiar për zgjedhje për organet e qeverisjes vendore klikon tek **“Raport për Zgjedhje të Qeverisjes Vendore”**, zgjedh datën e zgjedhjeve për të cilën do të raportojë dhe krijon kështu raportin.




Përdoruesi në fillim do të pyetet nëse ka diçka për të deklaruar. Nëse nuk ka asnjë gjë për të deklaruar, atëherë sistemi në mënyrë automatike do të zerojë të gjitha vlerat dhe raporti do të quhet i përfunduar, përndryshe financieri i partisë politike duhet të fillojë me deklarimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.



Përdoruesi do të pyetet nëse ka të ardhura për të deklaruar për kategorinë "**Të ardhura – financime publike**".




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë "**Të ardhura financime publike**" dhe më pas do të klikojë butonin **"Vazhdo."**




Përdoruesi kalon te kategoria tjetër dhe pyetet nëse ka të ardhura për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **"Po."**




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë “**Të ardhura monetare – financime jopublike**”. Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokumente që kanë lidhje me raportimin e këtyre të ardhurave.




Përdoruesi mund të shtojë të ardhura monetare financiare jopublike sipas nevojës, duke klikuar tek butoni “Shto të ardhura monetare”.

Shtojca nr. 1




Pasi mbaron me plotësimin e fushave, përdoruesi do të klikojë butonin **“Vazhdo”** për të kaluar te kategoria tjetër e të ardhurave dhe pyetet nëse ka “Dhurime në Natyrë” për të deklaruar. Në rast se ka, do të klikojë butonin **“Po.”**




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë “**Të ardhura, dhurime në natyrë – financime jopublike**”. Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokumente që kanë lidhje me raportin e të ardhurave.



Përdoruesi mund të shtojë dhurime në natyrë - financiare jopublike sipas nevojës, duke klikuar butonin "**+ Shto dhurime në natyrë**".




Pasi mbaron me plotësimin e fushave, përdoruesi do të klikojë butonin **"Vazhdo"** për të kaluar te kategoria tjetër e të ardhurave.




Financieri do të pyetet nëse ka për të deklaruar të ardhura të krijuara nga vetë partia. Nëse ka, do të klikojë butonin **"Po."**



Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë “**Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike – financime jopublike**”. Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokumente që kanë lidhje me raportimin e këtyre të ardhurave.




Financieri mund të shtojë të ardhura të krijuara nga vetë partia - financime jopublike sipas nevojës, duke klikuar butonin **“+ Shto të ardhura nga partia”**.




Pasi mbaron me plotësimin e fushave, përdoruesi do të klikojë butonin **“Ruaj ndryshimet”.**

Më pas financieri vazhdon me deklarimet te kategoria tjetër dhe pyetet nëse ka hua dhe kredi për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin "**Po**".

Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë "**Huatë dhe kreditë**". Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokumente që kanë lidhje me raportin e të ardhurave.




Përdoruesi mund të shtojë hua apo kredi tjetër nëse ka për të deklaruar duke klikuar butonin "**+ Shto hua dhe kredi**".



Përdoruesi, pasi mbaron me plotësimin e fushave, do të klikojë butonin **"Vazhdo."**




Përveç deklarimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të partisë, financieri ka detyrimin që në rastin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të deklarojë edhe gjithë të ardhurat dhe shpenzimet për kandidatët për kryetarë bashkie, si edhe për kandidatët e listave shumemërore në nivel bashkie.






Pasi mbaron me deklarimin e gjithë të ardhurave, përdoruesi do të pyetet nëse ka shpenzime për të deklaruar apo jo. Nëse ka, do të klikojë butonin **"Po",** përndryshe sistemi në mënyrë automatike do të zerojë vlerat e shpenzimeve.




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë "Shpenzimet e partisë". Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokumente që kanë lidhje me këtë kategori.




Përdoruesi mund të shtojë shpenzime sipas nevojës, duke klikuar tek butoni "+ **Shto shpenzim tjetër**".

Pasi mbarohet me plotësimin e fushave, klikohet butoni "**Vazhdo**".

Në përfundim të deklarimit të të gjithë të ardhurave dhe shpenzimeve, përdoruesi do të ketë mundësinë që të shohë në mënyrë të përmbledhur tek "**Detaje dhe përmbledhje**" një shumatore të të gjitha deklarimeve që ka bërë më herët.



# Shtimi i raportit për zgjedhje parlamentare

Përdoruesi zgjedh kategorinë **“Raport për zgjedhje parlamentare”.**




Përdoruesi do të pyetet nëse ka diçka për të deklaruar. Nëse nuk ka asnjë gjë për të deklaruar, atëherë sistemi në mënyrë automatike do të zerojë të gjitha vlerat. Në këtë moment raporti do të quhet i përfunduar, përndryshe partia politike apo kandidati duhet të fillojnë me deklarimin e të ardhurave/shpenzimeve.




Përdoruesi do të pyetet nëse ka të ardhura për të deklaruar për kategorinë “**Të ardhura – financime jopublike**”.



Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë **“Të ardhura financime publike”** dhe më pas do të klikojë butonin **“Vazhdo”.**




Përdoruesi do të pyetet nëse ka të ardhura monetare për të deklaruar.




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë **“Të ardhura monetare – financime jopublike”.**



Përdoruesi mund të shtojë të ardhura monetare financiare jopublike për të deklaruar.




Përdoruesi, pasi mbaron me plotësimin e fushave, do të klikojë butonin **"Vazhdo."**




Përdoruesi kalon te kategoria tjetër dhe pyetet nëse ka të ardhura për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **"Po."**



Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë "**Të ardhura, dhurime në natyrë– financime jopublike**".




Përdoruesi mund të shtojë të ardhura, dhurime në natyrë - financiare jopublike për të deklaruar.

Pasi mbaron me plotësimin e fushave, financieri do të klikojë butonin **"Vazhdo."**

Përdoruesi kalon te kategoria tjetër dhe pyetet nëse ka të ardhura të krijuara nga vetë partia politike për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **"Po."**




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë "**Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike**".



Përdoruesi mund të shtojë të ardhura nga partia.

Përdoruesi, pasi mbaron me plotësimin e fushave, do të klikojë butonin “**Vazhdo**”.



Përdoruesi kalon te kategoria tjetër dhe pyetet nëse ka hua dhe kredi për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **“Po.”**




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë **“Huatë dhe kreditë”.**




Më pas përdoruesi do të pyetet nëse ka shpenzime për të deklaruar.




Përdoruesi do të vazhdojë me plotësimin e fushave për kategoritë e zgjedhura të shpenzimeve.




Përdoruesi do të klikojë butonin “**Shto shpenzim tjetër**” nëse do të ketë shpenzime të tjera për të deklaruar dhe do të klikojë butonin **“Vazhdo”** për të kaluar te kategoria tjetër.

Në përfundim të deklarimit të gjithë të ardhurave dhe shpenzimeve, përdoruesi do të ketë mundësinë që të shohë në mënyrë të përmbledhur tek **“Detaje dhe përmbledhje”** një shumatore të të gjitha deklarimeve që ka bërë më herët.



# 5. Menu: Profili i financierit

Menuja "**Profili i financierit**" do të shfaqë informacionin personal të përdoruesit, në këtë rast financier. Informacioni personal përmban | Emrin | Mbiemrin | Nr Cel | E-mail | Nr ID.




# 6. Menu: Shto kandidat

Përdoruesi shkon tek menuja "**Shto kandidat**" për të krijuar një kandidat të ri.




Përdoruesi do të plotësojë të dhënat e kandidatit dhe klikon butonin **"Ruaj"** për ta ruajtur atë.




Përdoruesi do të ketë mundësinë për të fshirë një kandidat ose për ta çaktivizuar atë.




# 7. Menu: Shto miratues të raporteve

Përdoruesi shkon tek menuja **"Shto miratues të raporteve"** për të shtuar një miratues të ri (firma e dytë).




Përdoruesi do të plotësojë të dhënat e aprovuesit dhe klikon butonin “**Ruaj**” për ta ruajtur atë.




Përdoruesi do të ketë mundësinë të fshijë një miratues raportesh ose ta çaktivizojë atë.




# 8. Menu: Raportet e partisë politike

Financieri do të shohë listën e të gjithë raporteve që ka krijuar të ndara në dy kategori: 1. Raportet vjetore dhe 2. Raportet e fushatave zgjedhore.




# 9. Menu: Raportet e kandidatëve

Financieri do të ketë mundësinë që të shohë të gjitha raportet e zgjedhjeve të ngarkuara në sistem nga kandidatët e partisë së tij.




Përdoruesi do të  shohë  listën e raporteve të  kandidatëve të listave shumemërore për zgjedhje.

Shtojca nr. 1


Hapësira e Financierit
Informacion i Përmbledhur
Shto Raport Financiar
Shto Kandidat
Shto Miratues të Raporteve
Raportet e Partisë Politike
Raportet e Kandidatëve
Raportet e Kandidatëve
Financier Test
Financier
31
Lista e Raporteve te Kandidatëve
Raportet e Kandidatëve të listave shumëemërore
Raportet e Kandidatëve për Kryetar Bashkie
Nr | Krijuar nga | Zgjedhje | Miratuar në | Statusi
1 | Kandidati Kryetar | Zgjedhje te qeverisjes vendore | 28 Prill, 2023, 1:34 PM | DRAFT
2 | Kandidati Kryetar | Zgjedhje te qeverisjes vendore | 28 Prill, 2023, 1:18 PM | MIRATUAR
3 | Kandidati Kryetar | Zgjedhje te qeverisjes vendore | 28 Prill, 2023, 12:31 PM | DRAFT
4 | Kandidati Kryetar | Zgjedhje te qeverisjes vendore | 28 Prill, 2023, 11:40 AM | DRAFT
5 | Kandidati Kryetar | Zgjedhje te qeverisjes vendore | 28 Prill, 2023, 11:13 AM | DRAFT

Co-funded
by the European Union

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE

Co-funded and implemented
by the Council of Europe

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
TIRANE

# Portali Elektronik i Raportimit Financiar

## Manual Përdorimi | Financier – Raport Vjetor

*Ky manual është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.*

## Përmbajtja

1. Hyrje ........ 3
    1.1 Qëllimi i manualit ........ 4
2. Ndërfaqja e identifikimit te përdoruesit në sistem ........ 5
3. Menuja Kryesore ........ 11
4. Menu: Shto raport financiar ........ 11

# 1. Hyrje

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve.

Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore, të medias në raport me zgjedhjet.

Zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat në lidhje me procesin zgjedhor.

Ligji nr. 101/2020, krijoi një arkitekturë të re të administrimit zgjedhor me formimin e tre organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që janë:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

2. Komisioni Rregullator;

3. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Veprimtaria e KQZ-së, organeve drejtuese dhe administratës udhëhiqet sipas rastit nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe nga ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka planifikuar digjitalizimin e procesit të monitorimit të raporteve financiare të partive politike bazuar në kuadrin ligjor në fuqi: Kodi Zgjedhor, ligji për partitë politike dhe aktet nënligjore të KQZ-së për financimin e subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore. Është evidentuar nevoja për të zhvilluar një platformë online për të lehtësuar procesin e monitorimit të financave të partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Ky portal do të përmbajë disa faza të rëndësishme të financimit të partive politike për KQZ-në, që nga momenti i vetëdeklarimit të pasqyrave financiare nga partitë politike si për vit jozgjedhor, ashtu edhe për fushata zgjedhore, monitorimi i tyre gjatë procesit zgjedhor, përfshirja e KQZ-së përgjatë procesit të auditimit (komunikimet auditues - financier partie) dhe në fund vendimmarrja.

Portali i deklarimit online do të lehtësojë procesin e plotësimit të raporteve financiare, raporteve të monitoruesve gjatë fushatës zgjedhore dhe raporteve të auditimit duke i mundësuar në mënyrë elektronike, të shpejtë, të sigurt dhe duke minimizuar gabimet e mundshme, nëpërmjet zhvillimit të dokumenteve të sigurta elektronike.

## 1.1 Qëllimi i manualit

Manuali ka për qëllim shpjegimin e funksionaliteteve kryesore të ofruara nga ky sistem duke i ardhur në ndihmë financierit për raportin vjetor , i cili do të jetë përdorues i sistemit.

Të gjitha funksionalitet që ofron portali do të përshkruhen dhe do të ilustrohen me imazhe për të dhënë një shpjegim sa më të mirë me qëllim për të kuptuar të gjithë procesin që sistemi përfshin.

## 2. Ndërfaqja e identifikimit te përdoruesit në sistem

Përdoruesi nëpërmjet linkut të autorizuar nga KQZ-ja do të aksesojë ndërfaqen e portalit.

Më pas, përdoruesi plotëson fushat **E-mail** dhe **Fjalëkalimi** dhe më pas klikon **"Identifikohu"** për t'u identifikuar në sistem.

Përdoruesit do t'i kërkohet të ndryshojë fjalëkalimin njëpërdorimshëm që i jepet nga KQZ-ja.




Nëse përdoruesi vendos kredenciale të pasakta të **E-mail** dhe **Fjalëkalimit** një mesazh gabimi do t'i shfaqet që e lajmëron për kredenciale të pasakta.



Nëse përdoruesi ka harruar fjalëkalimin e tij dhe dëshiron ta ndryshojë, ai mund të klikojë mbi butonin “**Harruat Fjalëkalimin?**”




Duke klikuar mbi butonin “Harruat Fjalëkalimin?” përdoruesit do t’i kërkohet që të vendosë një e-mail ku do t’i dërgohet një kod për ndryshimin e fjalëkalimit.




Përdoruesi plotëson fushën me e-mail-in e tij dhe klikon mbi butonin **“Dërgo Kodin”** për të marrë kodin mbi ndryshimin e fjalëkalimit.



Përdoruesi hyn në adresën e e-mail-it, merr kodin e verifikimit që i është dërguar dhe e vendos tek ndërfaqja ku i është kërkuar dhe klikon butonin “Konfirmo”.




Përdoruesi vendos fjalëkalimin e ri dhe e konfirmon fjalëkalimin e ri. Pasi janë plotësuar fushat e fjalëkalimit, ai klikon mbi butonin “**Ruaj”** për të ndryshuar fjalëkalimin e tij.




Fjalëkalimi që vendos përdoruesi duhet të përmbajë 8 karaktere ose më shumë.

Nëse përdoruesi vendos një fjalëkalim që nuk i përmbush standardin, fjalëkalimi nuk mund të ruhet dhe shfaqet me një vijë të kuqe.




Nëse kodi nuk është dërguar ose ka skaduar, përdoruesi duhet të klikojë tek opsioni **“Nuk morët një kod? Ridërgo kodin”.**




Përdoruesi ka vendosur kredenciale të sakta dhe është identifikuar në sistem. Pasi përdoruesi është identifikuar me sukses në sistem, ai do të shikojë ndërfaqen me rolet e tij përkatëse.

## 3. Menuja Kryesore

Përdoruesi në menunë kryesore **"Informacion i Përmbledhur"** do të shohë në mënyrë grafike paraqitjen e përdoruesve të shtuar prej tij në sistem (kandidatë dhe miratues raportesh financiare), si dhe raportet e partisë (raporte vjetore, raporte për zgjedhjet për Kuvend, raporte për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore).




Përdoruesi do të shohë Menunë Kryesore Vertikale që përmban: **“Informacion i Përmbledhur”, “Shto Raport Financiar”, “Shto Kandidat”, “Shto Miratues të Raporteve”, “Raportet e Partisë Politike” dhe “Raportet e Kandidatëve”**.




Përdoruesi do të shohë Menunë Horizontale në të djathtë që do të ketë ikonën e profilit të përdoruesit, emrin me rolin e përdoruesit, ikonën e njoftimeve dhe ikonën e daljes nga sistemi.



# 4. Menu: Shto raport financiar

Përdoruesi për të shtuar një raport financiar duhet të klikojë tek menuja **"Shto raport financiar".**




Për të shtuar një raport financiar vjetor klikon tek **"Raporti vjetor"**, zgjedh vitin për të cilin do të raportojë dhe krijon kështu raportin.




Qysh në fillim, përdoruesi do të pyetet nëse ka të ardhura dhe shpenzime për të deklaruar.




Përdoruesi nëse klikon **“Jo”**, sistemi automatikisht zeron të gjitha vlerat për të ardhurat dhe shpenzimet dhe do të kalojë direkt tek bilanci.




Nëse klikon tek butoni **“Po”,** do të pyetet nëse ka të ardhura për të deklaruar.




E njëjta pyetje do t'i bëhet për çdo kategori të ardhurash.




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë **"Të ardhura financime publike"** dhe më pas do të klikojë butonin **"Ruaj ndryshimet".**

Shtojca nr. 2




Përdoruesi kalon te kategoria tjetër dhe pyetet nëse ka të ardhura për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin “**Po**”.




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë **“Të ardhura monetare– financime jopublike”**. Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokument që ka lidhje më raportin e të ardhurave.

Shtojca nr. 2




Përdoruesi mund të shtojë kategori tjetër nëse ka të ardhura monetare financiare jopublike për të deklaruar.




Përdoruesi pasi mbaron me plotësimin e fushave do të klikojë butonin **“Vazhdo”**.




Përdoruesi kalon te kategoria tjetër dhe pyetet nëse ka të ardhura për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **“Po”.**




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë **“Të ardhura, dhurime në natyrë– financime jopublike”**. Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokument që ka lidhje më raportin e të ardhurave.




Përdoruesi mund të shtojë kategori tjetër nëse ka të ardhura, dhurime në natyrë - financiare jopublike për të deklaruar.




Përdoruesi pasi mbaron me plotësimin e fushave do të klikojë butonin **“Vazhdo”.**

Përdoruesi kalon te kategoria tjetër dhe pyetet nëse ka të ardhura dhurime për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **“Po”.**




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë **“Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike– financime jopublike”**. Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokument që ka lidhje më raportin e të ardhurave.




Përdoruesi mund të shtojë kategori tjetër nëse ka të ardhura të krijuara nga vetë partia - financiare jopublike për të deklaruar.




Përdoruesi pasi mbaron me plotësimin e fushave do të klikojë butonin **"Vazhdo".**




Përdoruesi kalon te kategoria tjetër dhe pyetet nëse ka hua dhe kredi për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **"Po".**

Shtojca nr. 2




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë “**Huatë dhe kreditë”.** Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokument që ka lidhje me huatë dhe kreditë.




Përdoruesi mund të shtojë hua tjetër nëse ka për të deklaruar.




Përdoruesi, pasi mbaron me plotësimin e fushave, do të klikojë butonin **“Vazhdo”.**




Përdoruesi, pasi mbaron me deklarimin e të ardhurave, do të pyetet nëse ka shpenzime për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **“Po”.**




Përdoruesi do të plotësojë fushat e kategorisë **"Shpenzimet e partisë."** Gjithashtu, ai mund të shtojë foto ose dokument që ka lidhje me këtë kategori.




Përdoruesi mund të shtojë shpenzime të tjera nëse ka, aq sa të jetë e nevojshme.




Përdoruesi, pasi mbaron me plotësimin e fushave, do të klikojë butonin **“Vazhdo”.**




Përdoruesi, pasi mbaron me deklarimin e shpenzimeve të partisë, do të pyetet nëse ka bilanc dhe asete për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **“Po”.**

Shtojca nr. 2







Si fillim, përdoruesi do të plotësoje fushat e bilancit që u përkasin të dhënave për asetet afatgjata jomateriale.



Pasi ka plotësuar fushat, do të klikojë butonin “**Vazhdo**”.

Më pas përdoruesi do të plotësojë fushat e aseteve afatgjata materiale të ndara sipas kategorive **“Ndërtesa”, “Pajisje zyre/informatike”, “Mjete transporti”, “Investime të tjera afatgjata”.**




Pasi ka plotësuar gjithë fushat, do të klikojë butonin **“Vazhdo.”**




Përdoruesi, pasi mbaron me deklarimin e aseteve, do të pyetet nëse ka detyrime për të deklaruar. Nëse ka, do të klikojë butonin **“Po”.**




Përdoruesi do të plotësoje fushat e kategorisë **“Detyrimet”** duke vendosur manualisht gjendjen në fillim të vitit ushtrimor, shtesat gjatë vitit ushtrimor dhe pakësimet gjatë vitit ushtrimor.  Gjendja në mbyllje të vitit ushtrimor do të llogaritet në mënyrë automatike nga sistemi.

Shtojca nr. 2



Financier

| 1 Te Ardhurat | 2 Shpenzime | 3 Asetet | 4 Detyrimet | 5 Detaje & permbledhje | 6 Pozicioni Financiar |
|---|---|---|---|---|---|

| | Gjendja ne fillim te vitit ushtrimor | Shtesa gjate vitit ushtrimor | Pakesime gjate vitit ushtrimor | Gjendja ne mbyllje te vitit ushtrimor |
|---|---|---|---|---|
| Te pagueshme | Text | Text | Text | 0.00 |
| Te pagueshme per furnizime dhe sherbime | Text | Text | Text | 0.00 |
| Te pagueshme per kontribute per punonjesit | Text | Text | Text | 0.00 |
| Shteti/tatim taksa/tatim ne burim | Text | Text | Text | 0.00 |
| Deftesa te pagueshme (ndaj te treteve) | Text | Text | Text | 0.00 |
| Kontribute te marra ne advance | Text | Text | Text | 0.00 |
| Pajisje zyre, Informatike | Text | Text | Text | 0.00 |
| Mjete Transporti | Text | Text | Text | 0.00 |
| Investime te tjera afatgjata | Text | Text | Text | 0.00 |
| Grantet, Donacionet, Subvencionet | Text | 0.00 | Text | 0.00 |
| Kredite/Hua afatgjate | Text | 0.00 | Text | 0.00 |

Pasi ka plotësuar fushat, do të klikojë butonin **"Vazhdo."**

Përdoruesi do të plotësojë fushat "**Pozicioni Financiar**". Do të fillojë me kategorinë "**Aktivet".**



| 1 Te Ardhurat | 2 Shpenzime | 3 Asetet | 4 Detyrimet | 5 Detaje & permbledhje | 6 Pozicioni Financiar |
|---|---|---|---|---|---|

| | Periudha Raportuese | Periudha Paraardhese | Totali |
|---|---|---|---|
| Mjete Monetare | 0.00 | Text | 0.00 |
| Te drejta dhe interesi i arketueshem | Text | Text | Text |
| Kontribute te arketueshme | Text | Text | Text |
| Inventar dhe shpenzime te parapaguara | Text | Text | Text |
| Shuma | 0.00 | 0.00 | 0.00 |

Investime financiare Afatgjata

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ndërtesa | 0.00 | Text | 0.00 |
| Paisje zyre, Informatike | 0.00 | Text | 0.00 |
| Mjete transporti | 0.00 | Text | 0.00 |
| Investime të tjera afat gjata | 0.00 | Text | 0.00 |
| Shuma | 0.00 | 0.00 | 0.00 |

Pasi ka plotësuar fushat e kategorisë "**Aktivet**", përdoruesi do të klikojë butonin **"Vazhdo".**




Përdoruesi do të vazhdojë me plotësimin e fushave të detyrimeve tek “**Pozicioni Financiar**”.




Pasi ka plotësuar fushat e kategorisë “**Detyrimet**”, përdoruesi do të klikojë butonin **“Vazhdo”.**

Përdoruesi do të vazhdojë me plotësimin e kategorisë **"Aktivet Neto"** tek **"Pozicioni Financiar".**




Për lehtësi të ruajtjes së të dhënave nga përdoruesi, në rastet e raporteve financiare, raporti do të ruhet në mënyrë automatike nga sistemi sa herë që përdoruesi klikon tek një nga hapat pasardhës.

Në rastin kur përdoruesi ka plotësuar të gjitha të dhënat e nevojshme të raportit vjetor, mund ta dërgojë atë për aprovim tek miratuesi i raporteve (firma e dytë).

Përdoruesi, pasi dërgon për aprovim raportin, do të shohë një mesazh në ekran.




Nga ky moment do të vërehet edhe ndryshimi i statusit tek lista e raporteve nga **"Draft"** në **"Në pritje"** nga firma e dytë.




Pas aprovimit nga miratuesi i raporteve, raporti shkon në mënyrë automatike për aprovim tek KQZ-ja.

Në rastin kur KQZ-ja refuzon raportin, financieri do të njoftohet me e-mail dhe nga njoftimet e sistemit për ndryshimin e statusit të raportit.

Në klikim të raportit të refuzuar, do t'i shfaqet arsyeja e refuzimit të këtij raporti. Financieri ka mundësinë që të bëjë ndryshimet e nevojshme te raportit sipas komenteve të miratuesit të raporteve apo KQZ-së dhe ta ridërgojë atë për aprovim.

Pas aprovimit të raporteve nga miratuesi dhe KQZ-ja, financieri do të ketë mundësinë që ta shkarkojë raportin nëse do të jetë e nevojshme.

Nga ky moment, raportet do të bëhen gjithashtu publike dhe të aksesueshme tek URL https://fpp.kqz.gov.al/kreu

Shtojca nr. 3

Co-funded by the European Union

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE

Co-funded and implemented by the Council of Europe

# Portali Elektronik i Raportimit Financiar

# **Manual Teknik i Përdorimit | Monitorues**

KQZ

Available on the App Store

Get it on Google play

KQZShqiperi

KQZShqiperi

KQZShqiperi

KQZShqiperi

KQZShqiperi

www.kqz.gov.al

Shtojca nr. 3

# Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje ........ 5
   1.1 Qëllimi i manualit........ 6
2. Ndërfaqja e identifikimit të përdoruesit në sistem........ 7
3. Menuja kryesore........ 15
4. Menu: Profili i monitoruesit........ 17
5. Menu: Shto raport........ 19
6. Menu: Raportet e mia........ 26

*Ky manual është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.*

# Tabela e figurave

Figura 1. Identifikohu në sistem.

Figura 2. Kredencialet janë gabim.

Figura 3. Harrove fjalëkalimin?

Figura 4. Vendos *e-mail*-in për të rikuperuar fjalëkalimin.

Figura 5. Dërgo kodin.

Figura 6. Konfirmo.

Figura 7. Vendos fjalëkalim të ri.

Figura 8. Nuk morët një kod? Ridërgo kodin.

Figura 9. Statistika të raporteve të monitorimit.

Figura 10. Menu Kryesore Vertikale

Figura 11. Menu Kryesore Horizontale

Figura 12. Profili i monitoruesit.

Figura 13. Shto raport.

Figura 15. Zgjidh subjekt zgjedhor.

Figura 16. Shto zyrë zgjedhore.

Figura 17. Të dhënat e zyrës zgjedhore.

Figura 18. Çfarë konstaton?

Figura 19. Çfarë konstaton për kategorinë “Zyrë zgjedhore”?

Figura 20. Ngarko figura – Çfarë konstaton për kategorinë “Zyrë zgjedhore”.

Figura 21. Çfarë konstaton për kategorinë “Materiale propagandistike”?

Figura 21. Ngarko figura çfarë konstaton për kategorinë “Materiale propagandistike”.

Figura 22. Çfarë konstaton për kategorinë “Aktiviteti/Ngjarja e fushatës”?

Figura 23. Ngarko figura çfarë konstaton për kategorinë “Aktiviteti/Ngjarja e fushatës”.

Figura 24. Çfarë konstaton për kategorinë “Abuzimi i burimeve shtetërore”?

Figura 25. Ngarko figura çfarë konstaton për kategorinë “Abuzimi i burimeve shtetërore”.

Figura 26. Ruaj raportin.

Figura 27. Konfirmo procesin.

Figura 28. Lista me raportet.

# 1. Hyrje

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve.

Drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore, të medies në raport me zgjedhjet.

Zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat në lidhje me procesin zgjedhor.

Ligji nr. 101/2020 krijoi një arkitekturë të re të administrimit zgjedhor me formimin e tri organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që janë:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

2. Komisioni Rregullator;

3. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Veprimtaria e KQZ-së, organeve drejtuese dhe administratës udhëhiqet sipas rastit nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe nga ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka planifikuar digjitalizimin e procesit të monitorimit të raporteve financiare të partive politike bazuar në kuadrin ligjor në fuqi: Kodi Zgjedhor, ligji për partitë politike dhe aktet nënligjore të KQZ-së për financimin e subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore. Është evidentuar nevoja për të zhvilluar një platformë online për të lehtësuar procesin e monitorimit të financave të partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Ky portal do të përmbajë disa faza të rëndësishme të financimit të partive politike për KQZ-në, që nga momenti i vetëdeklarimit të pasqyrave financiare nga partitë politike si për vit jozgjedhor, ashtu edhe për fushata zgjedhore, monitorimi i tyre gjatë procesit zgjedhor, përfshirja e KQZ-së përgjatë procesit të auditimit (komunikimet auditues - financier partie) dhe në fund vendimmarrja.

Portali i deklarimit online do të lehtësojë procesin e plotësimit të raporteve financiare, raporteve të monitoruesve gjatë fushatës zgjedhore dhe raporteve të auditimit duke i mundësuar në mënyrë elektronike, të shpejtë, të sigurt dhe duke minimizuar gabimet e mundshme nëpërmjet zhvillimit të dokumenteve të sigurta elektronike.

## 1.1 Qëllimi i manualit

Manuali ka për qëllim shpjegimin e funksionaliteteve kryesore të ofruara nga ky sistem duke u ardhur në ndihmë monitoruesve, të cilët do të jenë një nga përdoruesit fundorë të sistemit.

Të gjitha funksionalitet që ofron portali do të përshkruhen dhe do të ilustrohen me imazhe për të dhënë një shpjegim sa më të mirë të gjithë proceseve të sistemit .

# 2. Ndërfaqja e identifikimit të përdoruesit në sistem

Përdoruesi do të aksesojë ndërfaqen e sistemit nëpërmjet linkut të autorizuar nga KQZ-ja.

Përdoruesi plotëson fushat **E-mail** dhe **Fjalëkalimi** dhe më pas klikon **"Identifikohu"** për t'u identifikuar në sistem.

Përdoruesit do t'i kërkohet të ndryshojë fjalëkalimin me një përdorim që i jepet nga KQZ-ja.




Figura 1. Identifikohu në sistem.

Nëse përdoruesi vendos kredenciale të pasakta të **E-mailit** dhe **Fjalëkalimit,** do t'i shfaqet një mesazh që e lajmëron për kredenciale të gabuara.




Figura 2. Kredencialet janë gabim.

Nëse përdoruesi ka harruar fjalëkalimin dhe dëshiron ta ndryshojë atë, ai mund të klikojë mbi butonin “**Harruat Fjalëkalimin?**”.




Figura 3. Harrove fjalëkalimin?

Duke klikuar mbi butonin "**Harruat Fjalëkalimin?",** përdoruesit do t'i kërkohet që të vendosë e-mail-in e regjistrimit nga KQZ-ja, ku do t'i dërgohet një kod për ndryshimin e fjalëkalimit.



Figura 4. Vendos *e-mail*-in për të rikuperuar fjalëkalimin.

Përdoruesi plotëson fushën me e-mail-in e tij dhe klikon mbi butonin **"Dërgo kodin"**.




Figura 5. Dërgo Kodin.

Përdoruesi hyn në adresën e e-mail-it, merr kodin e verifikimit që i është dërguar, e vendos atë tek ndërfaqja ku i është kërkuar dhe klikon butonin "**Konfirmo**".




Figura 6. Konfirmo.

Përdoruesi vendos dhe konfirmon atë. Pasi janë plotësuar fushat e fjalëkalimit, ai klikon mbi butonin “**Ruaj**” për të ndryshuar fjalëkalimin e tij.




Figura 7. Vendos fjalëkalim të ri.

Fjalëkalimi që vendos përdoruesi duhet të përmbajë 8 karaktere ose më shumë.

Nëse përdoruesi vendos një fjalëkalim që nuk e përmbush standardin, fjalëkalimi shfaqet me një vijë të kuqe dhe nuk mund të ruhet.




Figura 8. Standardi për fjalëkalimin e ri.

Nëse kodi nuk është dërguar ose ka skaduar, përdoruesi duhet të klikojë tek opsioni **“Nuk morët një kod? Ridërgo kodin”**.




Figura 9. Nuk morët një kod? Ridërgo kodin.

Përdoruesi ka vendosur kredenciale të sakta dhe është identifikuar në sistem. Pas kësaj ai do të shikojë ndërfaqen me të drejtat e tij përkatëse.

# 3. Menu Kryesore

Në menunë kryesore, përdoruesi do të shohë paraqitjen e raporteve të monitorimit në mënyrë grafike. Në raport do të pasqyrohet statusi i raportit: “Draft”, “Në pritje”, “Miratuar”, “Refuzuar”.




Figura 10. Statistika të raporteve të monitorimit.

Përdoruesi do të shohë Menunë Kryesore Vertikale, që do të ketë të përfshirë: **“Informacion i Përmbledhur”**, **“Shto raport”** dhe **“Raportet e mia”.**




Figura 11. Menu Kryesore Vertikale

Përdoruesi do të shohë Menunë Kryesore Horizontale në të djathtë, që do të ketë ikonën e profilit të përdoruesit, ikonën e njoftimeve dhe ikonën e daljes nga sistemi.




Figura 12. Menu Kryesore Horizontale

Në fund të platformës, përdoruesi do të mund të shohë akseset e lehtësuara, legjislacionin, rrjetet sociale dhe bordin e transparencës.




Figura 13. Footer i platformës.

# 4. Menu: Profili i Monitoruesit

Në menunë kryesore monitoruesi do të shohë ikonën e profilit të vet. Pasi klikon tek ikona, dritarja që do të shfaqet është si vijon:




Figura 14. Profili i monitoruesit.

Përdoruesi do të ketë mundësinë të bëjë përditësime të të dhënave. Pasi bën këto ndryshime, ai klikon tek butoni **“Ruaj”.** Të dhënat do të jenë ruajtur me sukses.

E vetmja e dhënë që nuk mund të ndryshohet është adresa e e-mailit. Në rastet kur ndryshimi i adresës së e-mailit është i domosdoshëm, monitoruesi duhet të bëjë kërkesë pranë KQZ-së për ndryshimin e saj.

# 5. Menu: Shto Raport

Përdoruesi shkon tek menuja "**Shto raport**" për të krijuar një raport të ri monitorimi.




Figura 15. Shto raport.

Përdoruesi do të zgjedhë datën **kur** ka ndodhur monitorimi, vendin **ku** ka ndodhur, **cili** është subjekti që po monitorohet (subjekt zgjedhor, kandidat apo institucion publik), të ngarkojë foto të vendit/ngjarjes për të cilin/ën po raportohet.

Në varësi se **cili** është subjekti që po monitorohet apo ka kryer shkelje, monitoruesit do t'i shfaqen për t'u plotësuar:




Figura 16. Subjekti i monitoruar

Në rast se përdoruesi do të zgjedhë që shkelja është kryer nga subjekti zgjedhor, ai duhet të zgjedhë subjektin.




Figura 17. Zgjidh subjekt zgjedhor.

Përdoruesi, sipas rastit, do të zgjedhë gjithashtu zyrën zgjedhore për të cilën do të raportojë apo ku ka ndodhur shkelja. Në rast se zyra zgjedhore nuk ndodhet në listë, ai duhet ta shtojë atë. Për të shtuar një zyrë zgjedhore, përdoruesi duhet të klikojë tek butoni **"Shto zyrë zgjedhore."**




Figura 18. Shto zyrë zgjedhore.

Përdoruesi duhet të plotësojë emrin/përshkrimin e zyrës zgjedhore, adresën dhe sipërfaqen e saj dhe më pas të klikojë butonin **"Ruaj."** Të dhënat e tjera si partia politike, qarku dhe bashkia plotësohen në mënyrë automatike nga ato çfarë monitoruesi ka deklaruar në fillim të raportit të monitorimit.



Figura 19. Të dhënat e zyrës zgjedhore.

Përdoruesi më pas do të zgjedhë "**Çfarë konstaton**". Janë katër grupet e mëdha të konstatimit të shkeljeve:

1- Zyra zgjedhore
2- Materiale propagandistike të fushatës zgjedhore
3- Aktiviteti/Ngjarja e fushatës
4- Abuzimi i burimeve shtetërore




Figura 20. Çfarë konstaton?

Në rast se zgjedh kategorinë "**Zyrat zgjedhore**", përdoruesit do t'i shfaqen opsionet si më poshtë:




Figura 21. Çfarë konstaton për kategorinë "Zyrë zgjedhore"?

Në varësi të shkeljes, përdoruesi duhet të zgjedhë një nga opsionet për kategori.

Për secilin nga opsionet, përdoruesi mund të shtojë informacion përshkrues dhe të ngarkojë foto.



Figura 22. Çfarë konstaton për kategorinë "Zyrë zgjedhore"

Nëse zgjedh kategorinë "**Materiale propagandistike të fushatës zgjedhore**", përdoruesi do të shohë këto opsione.




Figura 23. Çfarë konstaton për kategorinë "Materiale propagandistike"?

Për secilin nga opsionet, përdoruesi mund të shtojë informacion përshkrues (tekst i lirë) dhe të ngarkojë foto.




Figura 24. Çfarë konstaton për kategorinë "Materiale propagandistike" – Shto tekst dhe imazhe.

Nëse zgjedh kategorinë **"Aktiviteti/Ngjarja e fushatës"** do të shohë këto opsione.




Figura 25. Çfarë konstaton për kategorinë "Aktiviteti/Ngjarja e fushatës"?

Për secilin nga opsionet, përdoruesi mund të shtojë informacion përshkrues dhe të ngarkojë foto.




Figura 26. Ngarko imazhe çfarë konstaton për kategorinë “Aktiviteti/Ngjarja e fushatës”.

Nëse zgjedh kategorinë **“Abuzimi i burimeve shtetërore”,** përdoruesi do të shohë këto opsione.




Figura 27. Çfarë konstaton për kategorinë “Abuzimi i burimeve shtetërore”?

Për secilin nga opsionet, përdoruesi mund të shtojë informacion dhe të ngarkojë foto.




Figura 28. Ngarko figura çfarë konstaton për kategorinë “Abuzimi i burimeve shtetërore”.

Përdoruesi mund ta ruajë si draft raportin duke pasur kështu mundësinë që ta përditësojë sërish ose ta ngarkojë atë në sistem për aprovim.




Figura 29. Ruaj raportin.

Nëse klikon **“Ngarko në sistem”,** përdoruesit do t’i shfaqet një mesazh ku pyetet nëse është i sigurt që do të përfundojë veprimin apo jo.




Figura 30. Konfirmo procesin.

Duke klikuar **“Po”,** raporti ruhet dhe shfaqet një mesazh që është ruajtur me sukses, përndryshe monitoruesi mund të vazhdojë me përditësimin/plotësimin e raportit.

